



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme, e përkrahur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 si dhe në përputhje me marrëveshjen në mes Gjykatës Supreme dhe UNDP-së shpall konkurs:

KONKURS

Nr. 05/2018

Titulli i pozitës: Zyrtar Ligjor një pozitë

Vendi: Gjykata Supreme

Koeficienti: (niveli i pagës se caktuar nga donatori)

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti me mundësi vazhdimi

Mbikëqyrës: Kryetari i Gjykatës Supreme

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve profesionale duke kontribuar në mbarëvajtjen e punës së zyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme, përmes koordinimit të punëve, monitorimit të planit të punës me qëllim të arritjes së objektivave të parapara; si dhe ofrimin e këshillave profesionale.

Detyrat Kryesore:

1. Dhënia e asistencës teknike dhe profesionale për Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës;
2. Te ndihmoj në procesin e koordinimit të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të stafit të SPCO, KGJK dhe KPK;
3. Te ofroj mbështetje administrative dhe teknike përgjatë analizës së rasteve korruptive në gjykate dhe finalizimit të raportit;
4. Ofrimi i ndihmës teknike përmes hulumtimeve juridike për të hartuar rekomandime për udhëzime të politikës penale, përfshirë mbledhjen të dhënave në lidhje me zbatimin e udhëzuesit për politikën ndëshkimore;
5. Te ofroj mbështetje në facilitimin e bashkëpunimit në mes të Gjykatës Supreme, UNDP-se, si dhe aktereve të tjerë relevant;
6. Mbështetje në monitorim dhe vlerësim substancial të planit të miratuar të punës për arritjen e rezultateve duke theksuar rezultatet e ndara sipas gjinisë;
7. Te ofroj asistencë në draftimin e raporteve narrative dhe financiare të projektit të përbashkët në mes të UNDP dhe Gjykatës Supreme;

Shkathtësitë e kërkuara (kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohet për këtë vend të punës)

- Diplomë universitare (Juridik, 240 ECTS);
- Njohuri të ligjeve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Njohuri të procedurave gjyqësore;
- Njohuri të programeve të Microsoft Office përfshirë Excel dhe Access;
- Njohuri themelore të koncepteve statistikore;
- Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve tjera ligjore;
- Aftësi për të analizuar me hollësi dokumentet, mbajten me kujdes të regjistrin, si dhe organizimin e punës;
- Njohuri të gjuhëve zyrtare në Kosovë, dhe njohja e gjuhës angleze e obligueshme;

VEREJTJE:

1. Procedura e konkursit është hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
2. Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil Nr.03/L-149 dhe Rregullore, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil.
3. Kohëzgjatja e emërimit: është me kohë të caktuar një vit (jo karrierës) me mundësi vazhdimi.

Konkursi është publikuar më dt. 31.03.2018 dhe mbyllet me 14.04.2018

Aplikimi: Kërkesa ([Aplikacioni](#)) për punësim gjendet në Web portal: <http://www.gjyqesori-rks.org/> ose mundë ti merrni në kopje fizike në Gjykatën Supreme. Aplikacionet e plotësuara dorëzohen, personalisht apo përmes postës, në adresën: Gjykata Supreme e Kosovës-Pallati i Drejtësisë , objekti E- Lagja "Prishtina e Re", Rr.: "Nekibe Kelmendi" pn. Aplikacionet e dorëzuara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 ditëve të punës nga dita e dorëzimit në post, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në tel: 038/200-18780, prej orës 08:00 - 16:00.

1. Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrorë dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për shkak të numrit të madhe të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhure në listën e ngushtë do të kontaktohen.

2. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata, vërtetime apo kopjet e kontratave të punës, certifikata të tjera, dy rekomandime etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjiten dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.

Zgjedhja e kandidatëve për këtë pozitë do të bëhet bazuar në dokumentacionin e ofruar, rezultatet e testit me shkrim (??) dhe rezultatet e intervistës me gojë (??).